1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## **SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE**

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 7. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

---

## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi per njesi</b>	<b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë</b> _____					

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]



#### **Shtojca 4.**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

#### Skicimet, parametrat teknik etj:

1. Hipoklorit kalciumi. {*Calcium hypochlorite (Ca(OCl)<sub>2</sub>) CAS no.7778-54-3*} në përqendrim 30%-40%; ky preparat duhet të jetë në përputhje me parametrat e Komunitetit Europian (CE) dhe të shërbejë për dezinfektimin e ambjenteve dhe ujrave të ndotura. Paketimi: Në konfeksion plastik 20kg-50kg. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

2. Hipoklorit natriumi. {*Sodium hypochlorite (Na OCl) CAS no.7681-52-9*} në përqendrim 12%-15%. Ky preparat duhet të përdoret në pastrimin e banjove, myshkut, algave edhe si dezinfektues i depozitave të ujit dhe ambjenteve publike dhe ka efikasitet eliminues për viruset, bakteret dhe kërpudhat duke dezinfektuar sipërfaqet dhe pajisjet e ndryshme. Paketimi: në konfeksion plastik 5 deri 25 litra dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

3. Biocid dizinfektant me spektër të veprimit kundër viruseve, baktereve, kërpudhave, mykut etj. Lëndët bazë aktive e këtij preparati duhet të jenë komponime të amonit kuaternar, dhe përbërës të tjerë të shtuar sipas produktit. Preparati të jetë në formë të lëngshme, i tretshëm në ujë dhe i përshtatshëm për pajisjet dezinfektuese të tipit ULV dhe pompat me presion të ulët. Destinacioni i përdorimit: Në ambiente të brendshme, të jashtme si zyra, qendra sociale, shkolla, kopshte, rrugë, sheshe publike, holle të hapura, sheshe pushimi, ambiente pritje jashtë, rrugica hyrëse-dalëse, mure të jashtme godine, mure rrethuese, etj. Paketimi: në konfeksion plastik 1 deri 5 litra dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

---

**4.** Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse (milingona, miza, pleshta, rriqna, morra etj.) për ambiente të jashtme të godinave publike, arsimore, parqet publike, kanalizimet etj. Lëndët bazë aktive e këtij preparati duhet të jenë të klasës Piretroide me efekt të menjëhershëm dhe të zgjatur. Preparati të jetë në formë të lëngshme, i tretshëm në ujë dhe i përshtashëm për pajisjet dezinfektuese të tipit ULV dhe pompat me presion të ulët. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Duhet të ketë efekt të menjëhershëm dhe toksicitet të ulët/mesatar duke mos lënë mbetje pas përdorimit. Paketimi: Në konfeksion plastik 1 lt-5 lt. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

**5.** Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse (milingona, miza, pleshta, rriqna, morra etj.) për ambiente të brendshme të godinave publike, arsimore, bodrumet, vendstrehimet etj. Lëndët bazë aktive e këtij preparati duhet të jenë të klasës Piretroide në formë mikrokapsulare me efekt të zgjatur. Preparati të jetë në formë të lëngshme, i tretshëm në ujë dhe i përshtashëm për pajisjet dezinfektuese të tipit ULV dhe pompat me presion të ulët. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Duhet të ketë efekt të menjëhershëm dhe toksicitet të ulët/mesatar duke mos lënë mbetje pas përdorimit. Paketimi: Në konfeksion plastik 1 lt-5 lt. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

**6.** Insekticid për luftimin e furrtareve. Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë e klasës Neuro-nikotinoide në përqendrim 2%-2.5%, në trajtë xheli. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit i ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Paketimi: Në konfeksion plastik në formë shiringe 10g-30g. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

**7.** Rodenticid për luftimin e minjve në mjedise të hapura dhe të mbyllura. Ky preparat duhet të jetë i tipit pellet, pastabite ose block. Lënda bazë aktive e rodenticidit duhet të jetë e klasës Antikoagulantë me veprim të ngadalshëm ose kronik. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar i parrezikshëm për mjedisin. Për të evituar kontaktin rodenticidit me gjallesat e tjera përveç minjve dhe për t'i ruajtur nga agjentët atmosferikë duhet të jenë të veshuara me një shtresë e cila të jetë hidhëruese me anë të lëndëve aktive si Bitrex (*denatonium benzoate*, CAS no. 3734-33-6) ose ekuivalentin e tij të destinuar për këtë qëllim. Paketimi: Në konfeksion plastik 0.1kg - 5kg i ndarë në copa nga 10-15g secila. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

**8.** Adulticid për luftimin e grerëzave. Ky produkt të jetë i gatshëm në formën e bombulave për spërkatje në formë spraji, për luftimin e grerëzave në ambiente të jashtme. Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë adulticid i klasës Piretroide dhe përbërës të tjerë të shtuar sipas produktit. Paketimi: Në konfeksion metalik me mekanizëm sprucimi në formë aerosoli 500ml-1000ml. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

**9.** Preparat repelent për largimin e gjarpërinjve dhe zvarranikëve. Ky preparat duhet të jenë i tipit repelent me formulim granular. Lënda bazë aktive e repelentit duhet të jetë natyrale e përbërë nga lloje të ndryshme vajrash bimorë e cila kur aplikohet krijon efekt mjedisi të papëlqyeshëm për zvarranikët, veçanërisht tek gjarpërinjtë dhe është e padëmshme për njerëzit, kafshët dhe shpendët. Paketimi: Në konfeksion plastik ose metalik 0.5kg-2kg. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

---

**10.** Produkt për kapjen insekteve zvarritëse në formën e kurtheve në kuti plastike, ku mund të vendoset xheli me përmbajtje Imidacloprid, Thiamethoxam ose preparate ekuivalente të shoqëruara me lëndë atraktive për insektet zvarritëse, i futur në brendësi dhe pamundësi për kontakt të jashtëm. Kjo sjell tërheqjen e insekteve në brendësi të kutisë dhe konsumin e insekticidit. Përmasat: në formë rrethore me diametër 50mm-90mm ose në formë drejtkëndore me gjatësi dhe gjerësi 60mm-100mm me lartësi 15mm-20mm. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

**11.** Kutitë plastike për vendosjen e rodenticideve për përdorim në mjedise të mbyllura dhe të hapura, ku preparati është i futur në brendësi dhe nuk ka kontakt të jashtëm. Materiali i kutisë duhet të jetë rezistent ndaj agjentëve atmosferikë, shtypjeve dhe goditjeve dhe duhet të jetë i siguruar me çelës sigurie për mbyllje të sigurtë. Përmasat: në formë rrethore me diametër 20cm-30cm ose në formë drejtkëndore me gjatësi dhe gjerësi 15cm-30cm me lartësi 8cm-12cm me vrimë hyrje për minjtë me diametër 50mm-60mm. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

**Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Të gjitha paketimet e preparateve objekt prokurimi duhet të jenë të etiketuara në gjuhën shqipe referuar nenit 1 pika 1.2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 488, datë 29.6.2016 "Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve", pikës 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 487, datë 29.6.2016 "Për klasifikimin e produkteve biocide" dhe nenit 8 të Ligjit Nr.9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

#### Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia
1	Hipoklorid kalciumi	kg	12,000
2	Hipoklorid natriumi	litër	10,000
3	Biocid dizinfektant kundër baktereve, viruseve dhe kërpudhave	litër	6,600
4	Insekticid kundra insekteve fluturuese dhe zvarritëse në mjedise të hapura	litër	800
5	Insekticid kundër insekteve fluturuese dhe zvarritëse në mjedise të mbyllura	litër	140
6	Insekticid kundër furrtareve	kg	20
7	Rodenticide kundra brejtësve	kg	830
8	Bombul spërkatje në formë spraji, për luftimin e grerëzave	copë	600
9	Preparate për largimin e gjarpërinjve	kg	800
10	Kurthe plastike për luftimin e milingonave dhe insekteve të tjera në ambiente të mbyllura.	copë	500
11	Kuti plastike për vendosjen e rodenticideve	copë	480

#### Afatet e lëvrimit:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Hipoklorid kalciumi	kg	12,000	DPOP	12 muaj
2	Hipoklorid natriumi	litër	10,000	DPOP	12 muaj

<b>3</b>	Biocid dizinfektant kundër baktereve, viruseve dhe kërpudhave	litër	<b>6,600</b>	<b>DPOP</b>	<b>12 muaj</b>
<b>4</b>	Insekticid kundra insekteve fluturuese dhe zvarritëse në mjedise të hapura	litër	<b>800</b>	<b>DPOP</b>	<b>12 muaj</b>
<b>5</b>	Insekticid kundër insekteve fluturuese dhe zvarritëse në mjedise të mbyllura	litër	<b>140</b>	<b>DPOP</b>	<b>12 muaj</b>
<b>6</b>	Insekticid kundër furrtareve	kg	<b>20</b>	<b>DPOP</b>	<b>12 muaj</b>
<b>7</b>	Rodenticide kundra brejtësve	kg	<b>830</b>	<b>DPOP</b>	<b>12 muaj</b>
<b>8</b>	Adulticid për luftimin e grerëzave bombul spërkatje në formë spraji	copë	<b>600</b>	<b>DPOP</b>	<b>12 muaj</b>
<b>9</b>	Preparate për largimin e gjarpërinjve	kg	<b>800</b>	<b>DPOP</b>	<b>12 muaj</b>
<b>10</b>	Kurthe plastike për luftimin e milingonave dhe insekteve të tjera në ambiente të mbyllura.	copë	<b>500</b>	<b>DPOP</b>	<b>12 muaj</b>
<b>11</b>	Kuti plastike për vendosjen e rodenticideve	copë	<b>480</b>	<b>DPOP</b>	<b>12 muaj</b>

Shpjegim i termave: **DPOP** → Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë

**Grafiku i lëvrimit të mallit** do të njoftohet nga autoriteti kontraktor krahas çdo minikontrate që do të lidhet në zbatim dhe brenda afatit të marrëveshjes kuadër.

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me licensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (Biznesit), për vendosjen në treg të produkteve biocide. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë licenca e kërkuar është të detyrueshme për secilin operator ekonomik, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

**2.1.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

**2.1.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 14001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

**2.1.4** Organi i vlerësimit të konformitetit të certifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Shënim: Ky kriter (2.1.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues (akreditimi i entit certifikues) do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**2.1.5** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë certifikatat ISO të kërkuara janë të detyrueshme për secilin operator ekonomik, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.



---

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**2.2.2** Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2022 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

*Shënim: Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi/ distributori të autorizuar, për këtë procedurë prokurimi (objekt, nr.REF), ose autorizim prodhuesi/ distributori zyrtar për mallrat objekt të prokurimit. Në rast paraqitje deklaratë furnizimi/autorizim distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Deklarata e furnizimit/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

---

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi produkte insekticidë, adulticidë dhe rodenticidë (*produktet me nr.4 deri nr.8 në tabelën e Shtojcës 6*), duhet të paraqesë autorizim për bërjen të disponueshme në treg të produkteve biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm në shëndetin publik, të lëshuara nga organet kompetente shtetërore.

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues për të provuar efektin virucid (vrasjen e viruseve), baktericid (vrasjen e bakteve) dhe fungicid (vrasjen e kërpudhave) për produktin me emërtimin “Biocid dezinfektant kundër bakteve, viruseve dhe kërpudhave” (*Nr. Rendor 3(tre) i listës së paraqitur në tabelën e Shtojcës Nr.6*), duhet të paraqesë Çertifikatë Konfirmimit ose raport testimi të lëshuar nga ente certifikuese të akredituara dhe dokumentacionin që vërteton akreditimin e entit certifikues.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi hipoklorit kalciumi, hipoklorit natriumi, biocid dizinfektant, insekticidë, adulticidë dhe rodenticidë (*produktet me nr.1 deri nr.8 në tabelën e Shtojcës 6*), duhet të paraqesë dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të publikuara nga prodhuesi/it.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi (*produktet me nr.9 deri nr.11 në tabelën e Shtojcës 6*), duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi/it me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose qira të paktën 1 (një) automjet ATP (automjet i transportit të përzier) me karroceri të mbuluar. Për këtë duhet të paraqesë, Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin të vlefshme, ose në rast se i merr automjetet me qira të paraqesë kontratën e qirasë dhe dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e automjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin) të vlefshme.

*Shënim: Ky kriter (2.3.7) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion në paketim origjinal për produktet objekt prokurimi. Mostra e kërkuar duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë në përputhje me produktet e ofruara dhe specifikimet teknike të kërkuara.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I.Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

#### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<b>Emri (at) e subjekteve</b>	<b>NIPT-i</b>	<b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b>	<b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b>

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

### **A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

<b>Deklarata</b>	<b>Referencat (kur janë të zbatueshme)</b>
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm

<p>të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p>	<p>_____</p>

1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	<b>Po [ ]</b>
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	<b>Po [ ]</b>
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	<b>Po [ ]</b>
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	<b>Po [ ]</b>
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:  a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;  b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	<b>Po [ ]</b>
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	<b>Po [ ] Jo [ ]</b>
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose	<b>Po [ ] Jo [ ]</b>

angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).	
